



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:005002
Datë: 15.04.2024
Numri i dokumentit: 05571827

C.nr.72/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, DEGA NË NOVOBËRDË- Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari G.A me bashkëpunëtoresh profesionale B.S, në çështjen kontestimore të paditësit Q. H nga fshati M./D. Komuna e Gjilanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Z. S. avokat nga Gjilani, kundër të paditurve Z.B, R.B, M.B, M. B, Q.B, Rr. B, H.B, Xh. B, H.B, R.S, M.S dhe S.S, që të gjithë nga fshati M./D. Komuna e Gjilanit, me objekt kontesti vërtetim i të drejtës së pronësisë, vlera e kontestit 5,000.00 Euro, pas mbajtjes së seancës për shqyrtimit kryesor e publik, më datë 11.04.2024 mori, ndërsa me datë 12.04.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M
NË BAZË TË POHIMIT**

IAPROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e Q. H nga fshati M./D. Komuna e Gjilanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Z. S. avokat nga Gjilani, kundër të paditurve Z.B, R.B, M.B, M. B, Q.B, Rr. B, H.B, Xh. B, H.B, R.S, M.S dhe S.S, që të gjithë nga fshati M./D. Komuna e Gjilanit, dhe VËRTETOHET se paditësi është pronar i parcelës kadastrale me nr. P-70407028-00242-0, në sipërfaqe prej 1672 m², në vendin e quajtur ‘Fushë’ ZK D. e cila evidentohet në emër të A. (B.) H. me 1/1 pjesë të pronësisë sipas Certifikatës së pronësisë me numër të lëndës 015-19 e datës 02.07.2019.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, Q. H nga fshati M./D. Komuna e Gjilanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Z. S. avokat nga Gjilani, kundër të paditurve Z.B, R.B, M.B, M. B, Q.B, Rr. B, H.B, Xh. B, H.B, R.S, M.S dhe S.S, që të gjithë nga fshati M./D. Komuna e Gjilanit, me objekt kontesti vërtetim i të drejtës së pronësisë, vlera e kontestit 5,000.00 Euro.

Paditësi në padi, gjatë shqyrtimeve gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se: Paditësi, ngastrën 0022-0 e ka blerë në vitin 1984 nga A.S, tani i vdekur, ndërsa ky e kishte blerë nga i ndjeri H.A (B.) ish nga fshati D. i cili kishte pasu dy djem, por edhe ata kanë vdekur, ndërsa

pas vetes ka lënë nipat/mbesat me mbiemrin B. Padiësi të ndjerit pra paraarshësit të të paditurve ia kishte paguar në tërësi çmimin kontraktues në shumën prej 10,000.00 Marka dhe të njëjtën e ka në shfrytëzim që nga viti 1984. Andaj, kishte kërkuar nga gjykata që t'i njihet e drejta e pronësisë mbi bazën e parashkrimit fitues.

Të paditurit me përgjigjen në padi të datës 30.12.2020, e kanë pohuar kërkesëpadinë e padiësit në tërësi, dhe i kanë propozuar gjykatës që të aprovohet e bazuar padia e padiësit.

Gjykata, fillimisht e shqyrtoi legjitimitetin e palëve në procedurë, konform nenit Neni 76 i cili parashesh se: “ Gjatë tërë procedurës gjykata duhet të kujdeset, sipas detyrës zyrtare, nëse personi që paraqitet si palë mund të jetë palë në procedurë dhe nëse është me zotësi procedurale, nëse palën me pazotësi procedurale e përfaqëson përfaqësuesi i saj ligjor, dhe nëse përfaqësuesi ligjor ka autorizimin e veçantë, kur ai është i nevojshëm.” Gjykata vlerësoi se palët janë të autorizuar të jenë palë në procedurë, për shkak se mes paraardhësve të të paditurve dhe padiësit të parë, përkatësisht paraardhësit të padiësit të dytë ka ekzistuar një raport juridik-marrëveshje për shitblerjen e pronës, e cila është objekt i kontestit, ndërsa të njëjtit si trashëgimtarë, të cilët bartin autorimet e paraardhësve të tyre të ndjerë janë paraqitur si palë në këtë procedurë.(neni 2 i Ligjit për Trashëgiminë)

Gjykata, pas pohimit të kërkesëpadisë nga ana e të paditurve konstatoi se kërkesa është e disponueshme për palët, dhe nuk bie në kundërshtim me nenin 3 paragrafi 3 të të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) i cili parasheh se : “Gjykata nuk do t'i miratojë disponimet e palëve që janë në kundërshtim me: a) rendin juridik; b) dispozitat ligjore; c) rregullat e moralit publik.” Prandaj, në kuptim të nenit 148, paragrafit 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) – me të cilin përcaktohet se “në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit)”, vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr.72 /2020, me datë12.04.2024

Gjyqtari,
G. A

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Në kuptim të nenit 181 par. 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.